

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“HC Group” Sh.p.k.

Sot, më date **02.11.2021**, ne te nenshkruarit:

- **Zenel Hida** lindur me 22/10/1956, shtetas shqiptar, me residence ne Lushnje, identifikuar me leternjoftimin me Nr. 035793292, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

- **Antonio Costantino** lindur me 20/02/1977, shtetas italian, me residence ne Itali, identifikuar me karte identiteti me Nr. AU3288801, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar ; -në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar **“HC Group” Sh.p.k.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: **“HC Group” Sh.p.k**

Neni 2

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lagja “Kocaj”, rruga nacionale Lushnje-Berat, godine njekateshe zona kadastrale nr.2168, pasuria nr.85/36, Fiershegan ,Lushnje, Fier.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *hcgroupp@yahoo.it*
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Neni 4

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

-Transporti i mallrave ne rruge tokesore, e kombinuar me detare/ hekurudhore, transport, auotransport mallrash tokësor, e kombinuar me anije dhe hekurudhë, transport rrugor, shperndarje e mallrave per llogari te te treteve, kombetar/nderkombetar, ushtrimin e spedicioneve kombetare/nderkombetare te



mallrave me çfaredo lloj mjete; magazinim dhe/ose menaxhim të magazinave dhe për llogari të treteve, statusit e rregulloreve, për një rritje të qëllimeve shoqërore, teknike, ekonomike e pasurore, menaxhimin e oficinës së riparimeve të mjeteve në pronësi të kompanisë dhe/ose me qira, promovimin/studimin e merkates së sektorit; promovimin/berjen e kërkimeve në merkatën e sektorit; studimin, promovimin, kryerjen e riorganizimit të menaxhimin e magazinave për të tretë në vecanti me referencën e lay-out, për shpërndarjen e brendshme të mallrave, menaxhimin e shpenzimeve, në shkarkim-ngarkim, në ambalazhimin, kontrollin e cilësisë, vendosjen e etiketave, spedicionin, faturimin, menaxhimin e të gjitha dokumentave të transportit, asistencë për spedicionin, menaxhimin e praktikave të dëmtimeve, të praktikave të stokut, të perpunimit të të dhënave, faturimin për llogari të 2 treteve,

-Megjithatë shoqëria ka të drejtë që të shtojë dhe të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **1 000 000** Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Zenel Hida**: Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **500 000** leke që përbën **50 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ortaku themelues **Antonio Costantino**: Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **500 000** leke që përbën **50%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund të bëhet vetëm pasi Asambleja e ortakëve me shumicë e ka dekretuar këtë dhe për më tepër të gjithë ortakët janë të detyruar që ta repektojnë dhe të kontribuojnë në para ose në natyrë në bazë të vendimit të shumicës së asamblesë

Neni 7:

Transferimi i kapitalit



Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statur.

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqerisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqerisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përrjashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimmarres percaktohen ne statutin e shoqerise.

Neni 9

Administrimi


Aministratori i shoqerise emerohet Z. **Zenel Hida** lindur me 22/10/1956,shtetas shqiptar,me residence ne Lushnje, identifikuar me leternjoftimin me Nr. 035793292,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjesitë e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqerise.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqerisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjastimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.



Ekspteri ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cialt është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të percaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

ORTAKET E SHOQËRISË

Zenel Hida



Antonio Costantino

